



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 53, datë 15.02.2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 140 pika 3, shkronja “a”, dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2 shkronja “b”, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 151, pika 1, shkronja “a” dhe 155 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi informacionin e njoftuar me shkresën nr. 178 prot., datë 13.02.2021 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbi propozimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor,

**VENDOSI:**

1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, për aq kohë sa është në fuqi masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*”, caktuar me vendimin Nr.14, datë 10.02.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**